



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 718/3 prot.

Tiranë, më 10.03.2022

VENDIM

Nr. 17, datë 09.03.2022

**“PËR MIRATIM KANDIDATI PËR POZICIONIN E PUNËS ‘ADMINISTRATOR’
NË FAKULTETIN E SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE, TË UNIVERSITETIT
TË MJEKËSISË, TIRANË”**

Në bazë të nenit 3, 47, 52 pika 1 (shkronja e) të ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të nenit 51 pika 1 (shkronja s) të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Bordi i Administrimit, pasi mori në shqyrtim shkresën e Administratorit me nr.1988/52 prot., datë 01.03.2022, “Dërgohet për miratim, kandidati për pozicionin e punës ‘Administrator’ në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike” si dhe relacionin bashkëlidhur të komisionit *ad-hoc* me nr. 1988/48 prot., datë 21.02.2022 “Relacion mbi procedurën e konkurimit...”, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 09.03.2022, në mënyrë unanime,

VENDOSI:

1. Të miratojë kandidaturën e znj. Alketa Mukavelati, si Administrator i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ngarkohet sektori i Koordinimit Institucional, për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
ZAMIRA GJINI

ANËTARË

MONIKA FIDA

VERA OSTRENI

ALTINA XHAFERI

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ENDRIT YZEIRAJ